



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 2202/___ prot.

Tiranë, më ___ . ___ . 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: BOE AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F në masën 89.95 % dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3 dhe K A C D E D J A shpk me NIPT K51712017A në masën 10.05% dhe adresë Tirane Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dytë, përfaqësuar nga AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur - prokurim me mjete elektronike – punë publike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-72998-06-19-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i godinës së re të Laboratorëve në ISHP” me fond limit **384,988,709.39 (treqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntë.39) lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj nga njoftimi për fillimin e punimeve (sipas grafikut të punimeve të dhënë nga projektuesi).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 57 datë 26 Qershor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

Nr.	Operatori ekonomik	Ofertuar
1	DION-AL shpk me NIPT K67917301H dhe adresë: Tirane Bulevardi "Gjergj Fishta", kulla 2, kati 2	282'890'577.64 (dyqind e tetëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë.64) lekë pa tvsh
2	S I R E T A 2F shpk me NIPT K51501008J dhe adresë: Tirane Paskuqan Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan	305,280,497 (treqind e pesëmilion e dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh
3	ALBA KONSTRUKSION shpk me NIPT J61812013R dhe adresë, Tiranë Kryqëzimi i Rrugës Liman Kaba me Prokop Mima, Rezidenca Olimpik,Shkalla nr 3, Kati 2	306'942'515.35 (treqind e gjashtë milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë.35) lekë pa tvsh

4	BOE AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F në masën 89.95 % dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3 dhe K A C D E D J A shpk me NIPT K51712017A në masën 10.05% dhe adresë Tirane Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dytë, përfaqësuar nga AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3	342'831'733.20 (treqind e dyzet e dy milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre.20) lekë pa tvsh.
5	BOE AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I në masën 65% dhe adresë Tirane Bulevardi Zogu i Pare, Pallati prane Fakultetit te Shkencave, Tiranë, dhe DESARET COMPANY shpk me NIPT K01816001J në masën 35% dhe adresë Tirane Njesia Bashkiake nr 11, Rruga" Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret",Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe, përfaqësuar nga AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I dhe adresë Tirane Bulevardi Zogu i Pare, Pallati prane Fakultetit te Shkencave, Tiranë	353'613'604 (treqind e peëdhjetë e tremilion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa tvsh.
6	BOE BE - IS SH.P.K, shpk , me NIPT K71412003A në masën 30.06 % dhe adresë Kukes Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1 dhe 2 T shpk me NIPT K01731001M në masën 39.94% dhe adresë Tirane Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5 përfaqësuar nga BE - IS SH.P.K, shpk , me NIPT K71412003A dhe adresë Kukes Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1	355'307'385 (treqind e pesëdhjetë e pesë milion e treqind shtatë mijë e treqind tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh
7	GENERAL TRADING sh.p.k, shpk me NIPT M21501011F dhe adresë Tirane Peze Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga Ben Mjalti, Njësia Administrative Pezë	Pa ofertë ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:



a. DION-AL shpk me NIPT **K67917301H** dhe adresë: Tirane Bulevardi "Gjergj Fishta", kulla 2, kati 2, ofertuar në vlerën **282'890'577.64** (dyqind e tetëdhjetë e dy million e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë.64) lekë pa tvsh,

a.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE Dion.al rezulton se në sistem ka paraqitur dy preventiva. **PREVENTIVI_I_PUNIMEVE.pdf** si dhe dokumenti **Shtojca_2_-_Lista_e_cmimeve_sipas_zerave_te_preventivit_te_punimeve.pdf**.

Dokumenti

Shtojca_2__Lista_e_cmimeve_sipas_zerave_te_preventivit_te_punimeve.pdf nuk i

përmban të gjitha zërat e punimeve dhe sipas cmimeve të zërave nuk plotësohet oferta e shprehur në fjalë e OE.

Bazuar në vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 82, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 3:

3. *Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Sikurse citohet shprehimisht edhe në VKM, çmimi total i ofertës vjen si rrjedhojë e veprimeve aritmetike lidhur me zërat e preventivit nga ku dhe vlera e ofertës korrigjohet në bazë të veprimeve sipas gërmës “a” të pikës 3.

Operatori ekonomik ka paraqitur dy preventivë, ku shuma totale e njërit, nuk korrepondon me vlerën e ofertuar shprehur në fjalë dhe me shifra sipas zërave të preventivit të paraqitur në dokumentin **PREVENTIVI_I_PUNIMEVE.pdf** Për rrjedhojë ky operator me paraqitjen e dy preventivave rrjedhimisht ka paraqitur dy oferta me vlera të ndryshme nga njëra tjetra.

Sipas percaktimeve të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 79 **Dorëzimi i ofertave, pika 4:**

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative”.

a.2 Operatori ekonomik Dion.al rezulton që ka lidhur kontratën më *RFB no AL-MH-319398-CW-RFB* procedurë e realizuar nga projekti i BB pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku pjesë e procesit të vlerësimit të ofertave ka qenë një anetar i KVO i angazhuar në vlerësimin e kesaj procedure.

Nisur nga kjo indicie dhe bazuar në vetedeklarimin e OE sipas shtojcës 8 si dhe kushtit të përcaktuar mbi angazhimin e mjeteve ku përcaktohet:

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, staf i teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj.,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

KVO vendosi ti drejtohej me email zyrtar institucionit qe ka zhvilluar proceduren e prokurimit dhe eshte pergjegjes per ndjekjen e implementimit te kontrates ku në këtë rast është projekti i BANKES BOTERORE prane MSHMS-se (emaili dhe korrespondenca bashkelidhur ketij proces verbali)

Bazuar në nenin Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit NR. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin public”, pika 3 gërma:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

Teksti i dërguar nga KVO më datë 27.07.2020 ne adresat h****.****u@gmail.com; h****.*****i@gmail.com është si më poshtë vijon:

“Përshendetje

Ju lutem të na relatoni me shkrim, afatin e fillimit të punimeve dhe përfundimin e kontratës së lidhur me operatorin ekonomik Dion.al shpk me NIPT K67919301H dhe Arkonstudion shpk me NIPT L42019004I.

Sa është përqindja e realizimit të punimeve të objektit nga ky operator ekonomik për procedurën “Civil Works for the rehabilitation of Angiology/Cardio surgery in QSUT” RFB no AL-MH-319398-CW-RFB.

Gjithashtu lutem informacion konkret mbi pajisjet dhe fuqinë punëtore të angazhuar në këtë projekt nga ky operator.

*Lutem pergjigjen deri nese 28.07.2023 ora 12:00
Faleminderit”*

Me datë 27.03.2023 nga J**** S**** ne emailin e h****.****u@gmail.com vjen përgjigja si më poshtë:

Pershendetje,

Kontrata e lidhur midis MSHMS dhe JV Dion-Al dhe Arkonstudio sh.p.k eshte e depozituar ne protokollin e MSHMS me Nr. 745/20 prot date 24.05.2023 dhe mund ti referoheni tekstit te plote te saj. Gjithashtu nje kopje e ofertes se ketij bashkimi operatoresh eshte e depozituar ne MSHMS dhe ku mund te konsultoheni me permbajtjen e plote.

*Per lehtesi po ju dergoj bashkelidhur kontraten e skanuar shoqeruar dhe me anekset e saj design dhe oferten e plote (ne tre file zip per shkak te volumit) ku eprfshihet stafin dhe makinerite (pjesa e kontrates). Grafiku i punimeve te kontrates eshte 18 muaj kalendarike nga fillimi punimeve. Deri tani eshte raportuar qe punimet per kete kontrate nuk kane filluar ende. Per me shume info ne lidhje me statusine zbatimit te saj mund ti referoheni koordinatorit nga ana e MSHMS Z.B**** M*****.*

Me poshte per lehtesi po ju bej ekstrakt nga dokumentet e mesiperme stafin dhe makinerite por per etajet e plotes referojuni kontrates.

*Ne rast se keni nevojte mund te kaloni ne zyrtat tona per tu konsultuar me kopjet origjinale.
Dite te mbare,*

Pra sipas konfirmimit të mësipërm dhe dokumentacionit provues dërguar me email u vërtetua se pajisjet dhe mjetet të vetedeklaruara sipas shtojces 8 ne kete procedure prokurimi nga ky OE, janë të angazhuara edhe në projektin e Bankes Boterore.

Duke qenë se KVO ka në dispozicion dokumentacionin provues të angazhimit të mjeteve dhe personelit, datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës, kontraten, listën e mjeteve, listën inxhinierëve, etj, angazhuar në kontratën RFB no AL-MH-319398-CW-RFB, vendos që operatori ekonomik Dion.al nuk plotëson kapacitetet teknike dhe njerëzore që të mund të realizojë edhe procedurën “Ndërtimi i godinës së re të laboratoreve në ISHP”, pasi ky kusht është i percaktuar qarte ne DT konkretisht

2.3.4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojnë drejtuesit teknik për këtë vepër, të punësuar për periudhen e kërkuar Maj 2023, të cilët duhet të jenë të pranishëm

gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas grafikut të punimeve të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:

a.3 Nga shqyrtimi i ofertës është konstatuar se në llogaritjen e vlerës së ofertës pa TVSH (në të dy preventivat e paraqitur) OE ka aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, vlerës totale (punime me tvsh + pajisje), pra (punime me tvsh+pajisje)/1.2

Në rastin konkret si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik shfaqen në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë *lex specialis*, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Referuar dokumentacionit, punimet e kërkuara janë kategorizuar në:

- 1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**
- 2. PAJISJE**

Referuar udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, ndryshuar me udhëzimin Nr. 11, datë 13.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” Neni 20, “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, pargarafët 1,4 parashikohet:

TVSH-ja në ndërtim zbatohet:

1. Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.

4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:
 - a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;
 - b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSHsë të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbrësë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përsa kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar ndërtimi i një objekti që do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, referuar paragrafit 4 gërma "a"

a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Në rastin konkret, në përlllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH. Për sa kohë që paisjet e parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit kemi edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë:

- **vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH),**

Ndërsa vlera totale e ofertës ekonomike me TVSH, përfshin njëherazi edhe (+) 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

Kryerja e veprimeve aritmetike, në mbledhjen e zërave të deklaruar, ka sjellë si rrjedhojë edhe vlerën totale ku përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndryshme nga vlera totale e preventivit, e cila, përbën një gabim në një vlerë më të madh se 2% duke cënuar procesin e prokurimit publik.

Oferta ekonomike dhe përlllogaritja e zërave të deklaruar në preventivin e ofertës së kësaj procedure prokurimi, ka një llogaritje të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, vlera totale e preventivit pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, shërben si bazë për klasifikimin e ofertave, krahasimin e tyre, përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, si edhe mbi bazën e të cilës shqyrtohen dhe vlerësohet edhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart oferta e paraqitur me numra dhe me fjalë e operatorit ekonomik është:

282'890'577.64 (dyqind e tetëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë.64)**lekë pa tvsh**
dhe 339'468'693.17 (treqind e tridhjetë e nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre.17)lekë me tvsh.

Pra operatori ekonomik i ka aplikuar heqjen e TVSH-së, shumës totale, ku përfshihen edhe pajisjet.

Vlera e preventivit të ofertuar (**1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**) është 248'338'744.31 lekë pa tvsh ose 298'006'493.17 lekë me tvsh ndërsa vlera e pajisjeve ofertur (**2. PAJISJE**) është 41'462'200 lekë.

Vlera e ofertës pa tvsh DUHET të ishte:

(Punime ndërtimi dhe instalime pa tvsh)248'338'744.31+41'462'200(pajisje)=**289'800'944.31 lekë pa tvsh**

Vlera ekonomike pa tvsh është vlerë referuese për efekt krahasimi dhe vlerësimi të ofertave, vlera absolute e të gjitha korrigjimeve, në këtë rast, është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave" Nr. 162/2020 "PËR PROKURIMIN PUBLIK", përcaktohet se:

"2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet."

Në Nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK" i ndryshuar, parashikohet se:

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij.
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.
- d) Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- **shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;**
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

Kuadri ligjor në fuqi, *lex specialis* ka parashikuar rastet në të cilat, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton gabime aritmetike në hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. *Racio* e rregullimeve në rastet e gabimeve aritmetike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë, e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, Neni 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” i cili parashikon se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Gjithashtu, në interpretim sistematik dhe domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera të sistemit, konstatimi dhe mundësia e korigjimit të gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike dhe rregullimet përkatëse, në thelb paraqiten si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ato të transperencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertuesin (**si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës**).

KVO këtë gjykim përvec zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, e mbështet edhe në vendimet e KLSH dhe të KPP.

KLSH për këtë rast shprehet:

..... AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. **Oferta ekonomike duhej të paraqitet si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit..... (Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie” Prill 2021)**

Si dhe vendimin e **K.P.P. 621/2019** ku citon:

Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përlogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen sëbashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e Dion.al shpk nuk kualifikohet



b.S I R E T A 2F shpk me NIPT **K51501008J** dhe adresë: Tirane Paskuqan Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, ofertuar në vlerën **305,280,497 (treqind e pesëmilion e dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.**

b.1 Operatori ekonomik për pajisjet me numër rendor 7, 8, 9, 10,11 ka deklaruar që do të furnizohen nga subjekti G&R. Subjekti G&R autorizon subjektin Smart Clima Solution. Nga kontrolli në faqen e QKB rezulton që operatori G&R nuk është prodhues i pajisjeve

7	<i>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 01 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë të mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 13373 m3/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter</i>
---	---

	<i>G4 (Hyrje dhe Dalje), Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 40/48 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 86 kg/h(47 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</i>
8	<i>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 02/04 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 2948 m3/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 (Hyrje dhe Dalje), Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 9/11 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 20 kg/h (16 kW). Dimensionet 1600x1100x4810 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</i>
9	<i>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 03 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 15844 m3/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 (Hyrje dhe Dalje), Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 48/63 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 102 kg/h(2*35 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</i>
10	<i>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 05 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 19538 m3/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 (Hyrje dhe Dalje), Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 58/79 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 126 kg/h (2*45 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</i>
11	<i>Njesi e trajtimit të ajrit AHU 06 : Konstruksioni perbëhet nga profil special alumini , i cili lidhet me qoshet e aluminit . Anët e konstruksionit janë te mbyllura me panele izolimi termik dhe akustik . Në strukturë janë inkorporuar të gjitha elementet per trajtimin e ajrit . Prurja e ajrit Q= 16134 m3/h . Seksioni i rekuperimit 80 % me rryma te kunderta . Seksioni i filtrimit : Filter G4 (Hyrje dhe Dalje), Filter F7 ne hyrje . Bateri uji ftohje/ngrohje 51/68 kW. Presioni në dergim 350 Pa dhe kthim 350 Pa. Gjenerator avulli 110 kg/h(2*35 kW). Dimensionet 2700x1220x5680 mm . Montimi , testimi dhe dorëzimi sipas përshkrimit në projekt , specifikimeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesit.</i>

(pasi një subjekt prodhues duhet ti nënshtrohet procedurave të licensimit përkatës të legjislacionit Shqiptar në fuqi) dhe ka si objekt veprimtarie: “Tregtim, prodhim dhe instalim i pjeseve te aparateve per ventilim, filtrimin e kondicionimin e ajrit, import eksport, artikuj te ndryshem, elektroshtepiake, konfeksione, materiale inerte per ndertim.” cka bie ne kundershtim me kriterin e percaktuar ne KVK te DST ku:

2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim (i dedikuar për këtë procedurë prokurimi) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.

b.2 Për pajisjen më numër rendor 1 është paraqitur një autorizim për ITE nga ALBESOL shpk.

1. Ky autorizim është në gjuhën angleze, kjo në kundërshtim me përcaktimet e DST:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

dhe shtojca 7:

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Në bazë të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 24, Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët, pika 2:

2. *Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht

2. Ky autorizim mban datën 28.08.2020 i lëshuar për ITE GROUP Sh.p.k dhe nuk është autorizim por citon:

*“.....Guarantee that the MV switchgears type **SM6 up to 24kV** with brand Schneider Electric if correctly installed **CCBS sh.p.k stabiliment** , properly operated and maintained , should give satisfactory performance for a period of 12 months from July 2020....”*

Pra ky autorizim është dhënë për instalimin e këtyre pajisjeve në ambientet e subjektit CCBS sh.p.k dhe nuk figuron te kete asnje lidhje me kete procedure prokurimi.

Për të njëjtën pajisje është paraqitur autozim nga SCHNEIDER ELEKTRIC BULGARIA EOOD, por në kundërshtim me përcaktimet e DT **ky katalog nuk është i përkthyer në gjuhën Shqipe, por është në gjuhën angleze.**

Në bazë të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 24 Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët, pika 2:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht

b.3 Në tabelën e deklaramit të pajisjeve, **për pajisjen me numër rendor**

15	<i>Kompleti i pompës zjarrfikëse sipas EN12845 i përbërë nga: - 1 pompë elektrike kryesore 1x18,5 kW Pompë centrifugale horizontale njëfazore me thithje aksiale, portë shkarkimi radial dhe konstruksion me tërheqje mbrapa. Me performancë sipas ISO 9906:2012 - Grada 3B - 1 Motorpompë me rezervë motori me djegie të brendshme 1x 18.5 kW sipas ISO 3046 (10.9.1) ku secili jep Q=66.84 m3/h; H=51,13 m; - Pompë pilot "Jockey" 1x1.1 kW, komplet i kompletuar me panel kontrolli dhe ndërprerës presioni për çdo pompë. Kompleti i provës me Flowmeter, enë zgjerimi për pompën pilot. Në anën e dorëzimit, nyje kundër vibrimit. Pompa - 2 copë, valvola - 2 copë, valvola moskthimi - 2 copë, kolektori i dërgesës DN80. Rezervuari i karburantit dizel për 6 orë pavarësi pune me frenim të rrjedhjeve.</i>
----	--

nuk është specifikuar prodhuesi apo distributori i autorizuar sipas kërkesave, kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT ku kërkohej:

2.3.11. Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, vendin e prodhimit për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

- b.4** Për pajisjen me numër rendor 6 është deklaruar prodhuesi HAIER. Për këtë është paraqitur autorizim për Smart Clima Solution, nga Best Tech AL 2000 shpk i cili deklaroi që është distributor i autorizuar i HAIER por që nuk është paraqitur asnjë lidhje ndërmjet prodhuesit HAIER dhe Best Tech AL 2000 shpk, kjo në kundërshtim me kërkesat e DT ku kërkohej:

2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim (i dedikuar për këtë procedurë prokurimi) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.

b.5 Për pajisjet me numër rendor 13 dhe 14 është deklaruar se do të furnizohen nga MORIS HELLAS Greqi.

Për mbushjen e këtij kriteri është paraqitur autorizim nga KLEO ASHENSOR i cili deklaron që është distributor i autorizuar i prodhuesit MORIS HELLAS.

Autorizimi i prodhuesit për Kleo Ashensor nuk është nga MORIS HELLAS por është nga AH-MET ASANSOR SANAYI VE TIC.LTD. STI, Turqi dhe me MORI HELLAS nuk është paraqitur asnjë lidhje për të vërtetuar autorizimin e distributorit nga ky prodhues për KLEO ASHENSOR.

Këto në kundërshtim me pikën **2.3.11.a** të DT:

2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim (i dedikuar për këtë procedurë prokurimi) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.

b.6 Nga shqyrtimi i ofertës është konstatuar se në llogaritjen e vlerës së ofertës pa tvsh OE ka aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, vlerës totale (punime me tvsh + pajisje), pra (punime me tvsh+pajisje)/1.2

Në rastin konkret si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik shfaqen në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë *lex specialis*, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Referuar dokumentacionit, punimet e kërkuara janë kategorizuar në:

- 1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**
- 2. PAJISJE**

Referuar udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, ndryshuar me udhëzimin Nr. 11, datë 13.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” Neni 20, “Punimet e ndërtimit, kryerja e

procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, pargrafët 1,4 parashikohet:

TVSH-ja në ndërtim zbatohet:

1. Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.
4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:
 - a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;
 - b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSHsë të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përsa kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar ndërtimi i një objekti që do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma "a"

a), ku objekti që ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Në rastin konkret, në përlllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH.

Për sa kohë që paisjet e parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohej me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë **vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohej së bashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.**

Kryerja e veprimeve aritmetike, në mbledhjen e zërave të deklaruar, ka sjellë si rrjedhojë edhe vlerën totale ku përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndryshme nga vlera totale e preventivit, e cila, përbën një gabim në një vlerë më të madh se 2% duke cënuar procesin e prokurimit publik. Oferta ekonomike dhe përlllogaritja e zërave të deklaruar në preventivin e ofertës së kësaj procedure prokurimi, ka një llogaritje të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, vlera totale e preventivit pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, shërben si bazë për klasifikimin e ofertave, krahasimin e tyre, përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, si edhe mbi bazën e të cilës shqyrtohen dhe vlerësohet edhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart oferta e paraqitur me numra dhe me fjalë e operatorit ekonomik është: **305'280'497(treqind e pesëmilion e dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh** dhe 366'336'596(treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh.

Pra operatori ekonomik i ka aplikuar heqjen e TVSH-së, shumës totale, ku përfshihen edhe pajisjet.

Vlera e preventivit të ofertuar (**1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**) pa tvsh është 269'429'830 lekë pa tvsh ose 323'315'796 lekë me tvsh, ndërsa vlera e pajisjeve (**2. PAJISJE**) është 43'020'800 lekë

Oferta e operatorit pa tvsh **DUHET** të ishte:

(Punime ndërtimi dhe instalime pa tvsh) 269'429'830+43'020'800(pajisje)=**312'450'630 lekë pa tvsh.**

Vlera ekonomike pa tvsh është vlerë referuese për efekt krahasimi dhe vlerësimi të ofertave, vlera absolute e të gjitha korigjimeve, në këtë rast, është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, përcaktohet se:

“2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.”

Në Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

3. *Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

- a) *Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.*
- b) *Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.*
- c) *Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.*
- d) *Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korigjohet.*

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- **shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;**
- *shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.*

Kuadri ligjor në fuqi, *lex specialis* ka parashikuar rastet në të cilat, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton gabime aritmetike në hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. *Racio* e rregullimeve në rastet e gabimeve aritmetike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë, e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, Neni 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” i cili parashikon se:

1. *Pas afatit përfundimtar për hapjen e **ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës**, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*

2. *Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*
3. *Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.*

Gjithashtu, në interpretim sistematik dhe domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera të sistemit, konstatimi dhe mundësia e korigjimit të gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike dhe rregullimet përkatëse, në thelb paraqiten si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ato të transparencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertuesin (**si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës**).

KVO këtë gjykim përvec zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, e mbështet edhe në vendimet e KLSH dhe të KPP.

KLSH për këtë rast shprehet:

*..... AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përllogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. **Oferta ekonomike duhej të paraqitej si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit..... (Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmëri” Prill 2021)***

*Si dhe vendimin e **K.P.P. 621/2019** ku citon:*

Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen sëbashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e S I R E T A 2F shpk nuk kualifikohet



c.ALBA KONSTRUKSION shpk me NIPT J61812013R dhe adresë, Tiranë Kryqëzimi i Rrugës Liman Kaba me Prokop Mima, Rezidenca Olimpik, Shkalla nr 3, Kati 2, ofertuar në vlerën 306'942'515.35 (treqind e gjashtë milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë.35) lekë pa tvsh.

c.1 Operatori ekonomik **Alba Konstruksion** rezulton që ka lidhur kontratën *REF-AL-MH-332201-CW-RFB* procedurë e realizuar nga projekti i BB pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku pjesë e procesit të vlerësimit të ofertave ka qenë një anetar i KVO i angazhuar në vlerësimin e kesaj procedure.

Nisur nga kjo indicie dhe bazuar në vetedeklarimin e OE sipas shtojcës 8 si dhe kushtit të përcaktuar mbi angazhimin e mjeteve ku:
ku përcaktohet:

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jënë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, staf i teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj.,

i dekluar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

KVO vendosi ti drejtohej me email zyrtar institucionit që ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe është përgjegjës për ndjekjen e implementimit të kontratës ku në këtë rast është projekti i BANKES BOTERORE pranë MSHMS-se. (emaili dhe korrespondenca bashkelidhur këtij proces verbal)

Bazuar në nenin Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit NR. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin public”, pika 3 gërma:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mundësinë e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

Teksti i dërguar nga KVO më datë 27.07.2020 në adresat h***.****u@gmail.com; h****.****i@gmail.com është si më poshtë vijon:

“Përshendetje

Ju lutem të na relatonini me shkrim, afatin e fillimit të punimeve dhe përfundimin e kontratës së lidhur me operatorin ekonomik Alba Konstruksion me NIPT J61812013R.

Sa është përqindja e realizimit të punimeve të objektit nga ky operator ekonomik për procedurën “Civil works for the rehabilitation of KRUJA Hospital” REF-AL-MH-332201-CW-RFB.

Gjithashtu lutem informacion konkret mbi pajisjet dhe fuqinë punëtore të angazhuar në këtë projekt nga ky operator.

Lutem përgjigjen deri nesër 28.07.2023 ora 12:00

Faleminderit”

Me datë 28.03.2023 solli përgjigjen vjen përgjigjia simëposhtë:

“Përshendetje,

Kontrata e lidhur midis MSHMS dhe Alba Konstruksion sh.p.k është e depozituar në protokollin e MSHMS me 419/12 datë 19.06.2023 dhe mund të referoheni tekstit të plotë të saj. Gjithashtu një kopje e ofertes së këtij operatori është e depozituar në MSHMS dhe ku mund të konsultoheni me përmbajtjen e plotë.

Per lehtësi po ju dergoj bashkelidhur kontraten e skanuar shoqeruar dhe me anekset e saj design dhe oferten e plotë (në tre file zip për shkak të volumit) ku përfshihet stafi dhe makinerite (pjesë e kontratës).

Grafiku i punimeve të kontratës është 12 muaj kalendarikë nga fillimi i punimeve. Deri tani është raportuar që punimet kanë filluar me datë 13 Korrik 2023 dhe nuk është paraqitur ende asnjë

situacion. Per me shume info ne lidhje me statusine zbatimit te saj mund ti referoheni koordinatorit nga ana e MSHMS Znj. V**** H*****.

Me poshte per lehtesi po ju bej ekstrakt nga dokumentet e mesiperme stafin dhe makinerite por per detajet e plotes referojuni kontrates.

Ne rast se keni nevojë mund te kaloni ne zyrat tona per tu konsultuar me kopjet origjinale. Dite te mbare,”

Pra sipas konfirmimit të mësipërm dhe dokumentacionit provues dërguar me email u vërtetua se pajisjet dhe mjetet te vetedeklaruara sipas shtojces 8 ne kete procedure prokurimi nga ky OE, janë të angazhuara edhe në projektin e Bankes Boterore. Duke qenë se KVO ka në dispozicion dokumentacionin provues të angazhimit të mjeteve dhe personelit, datët e fillimit dhe përfundimit të kontratës, kontraten, listën e mjeteve, listën inxhinierëve, etj, angazhuar në kontratën REF-AL-MH-332201-CW-RFB, vendos që operatori ekonomik Alba Konstruksion nuk plotëson kapacitetet teknike dhe njerëzore që të mund të realizojë edhe procedurën “Ndërtimi i godinës së re të laboratoreve në ISHP”, pasi ky kusht është i përcaktuar qarte ne DT konkretisht

2.3.4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojnë drejtuesit teknik për këtë vepër, të punësuar për periudhën e kërkuar **Maj 2023, të cilët duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas grafikut të punimeve të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:**

c.2 Operatori ekonomik Alba Konstruksion nepermjet shtojces 8deklaron se do të mbështetet në kapacitetet e OE “METEO” sh.p.k, me NIPT L26310801C dhe operatorit “O.B KONSTRUKSION” sh.p.k, me NIPT K93728201A. Sipas DST pika 2.16 përcaktohet shprehimisht:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po Jo

Operatori ekonomik nuk ka patur pretendime përse i përket këtij kriteri, në fazën e pranimit të dokumentave. Për rrjedhojë cdo operator është i detyruar ti plotësojë të gjitha kriteret e përcaktuara në DT.

Sqarojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha **kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.**

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më lart mbështetja e OE në kapacitete të tjera është në kundërshtim më përcaktimet e AK në DT.

c.3 Nga shqyrtimi i ofertës është konstatuar se në llogaritjen e vlerës së ofertës pa tvsh OE ka aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, vlerës totale (punime me tvsh + pajisje), pra (punime me tvsh+pajisje)/1.2

Në rastin konkret si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik shfaqen në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë *lex specialis*, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Referuar dokumentacionit, punimet e kërkuara janë kategorizuar në:

- 1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**
- 2. PAJISJE**

Referuar udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, ndryshuar me udhëzimin Nr. 11, datë 13.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” Neni 20, “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, paragrafët 1,4 parashikohet:

TVSH-ja në ndërtim zbatohet:

1. Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial.TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me

faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.

4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:
 - a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;
 - b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSHsë të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përsa kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar ndërtimi i një objekti që do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma "a"

a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Në rastin konkret, në përlllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH.

Për sa kohë që paisjet e parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohehen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë **vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohehen së bashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.**

Kryerja e veprimeve aritmetike, në mbledhjen e zërave të deklaruar, ka sjellë si rrjedhojë edhe vlerën totale ku përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndryshme nga vlera totale e preventivit, e cila, përbën një gabim në një vlerë më të madh se 2% duke cënuar procesin e prokurimit publik.

Oferta ekonomike dhe përllogaritja e zërave të deklaruar në preventivin e ofertës së kësaj procedure prokurimi, ka një llogaritje të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, vlera totale e preventivit pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, shërben si bazë për klasifikimin e ofertave, krahasimin e tyre, përllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, si edhe mbi bazën e të cilës shqyrtohen dhe vlerësohet edhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart oferta e paraqitur me numra dhe me fjalë e operatorit ekonomik 306'942'515.35 (treqind e gjashtëmilion e nëntëqin e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë.35)lekë pa tvsh dhe 368'331'018.42 (treqind e gjashtëdhjetë e tetëmilion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëmbëdhjetë.42)lekë me tvsh. Pra operatori ekonomik i ka aplikuar heqjen e TVSH-së, shumës totale, ku përfshihen edhe pajisjet.

Vlera e preventivit të ofertuar (**1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**) është 267'714'110.35 lekë pa tvsh ose 321'256'932.42 lekë me tvsh ndërsa vlera e pajisjeve (**2. PAJISJE**) është 47'074'086 lekë.

Oferta e operatorit pa tvsh **DUHET** të ishte:

(Punime ndërtimi dhe instalime pa tvsh) 267'714'110.35 +47'074'086 (pajisje)= 314,788,196.35 lekë pa tvsh

Vlera ekonomike pa tvsh është vlerë referuese për efekt krahasimi dhe vlerësimi të ofertave, vlera absolute e të gjitha korrigjimeve, në këtë rast, është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, përcaktohet se:

“2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.”

Në Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, parashikohet se:

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*

- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.
- d) Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- **shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;**
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

Kuadri ligjor në fuqi, *lex specialis* ka parashikuar rastet në të cilat, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton gabime aritmetike në hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. *Racio* e rregullimeve në rastet e gabimeve aritmetike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë, e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, Neni 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” i cili parashikon se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e **ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës**, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Gjithashtu, në interpretim sistematik dhe domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera të sistemit, konstatimi dhe mundësia e korrigjimit të gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike dhe rregullimet përkatëse, në thelb paraqiten si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ato të transperencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertuesin (**si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës**).

KVO këtë gjykim përveç zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, e mbështet edhe në vendimet e KLSH dhe të KPP.

KLSH për këtë rast shprehet:

..... AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. **Oferta ekonomike duhej të paraqitej si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit..... (Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie” Prill 2021)**

Si dhe vendimin e **K.P.P. 621/2019** ku citon:

Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përlogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen sëbashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e ALBA KONSTRUKSION shpk nuk kualifikohet



e. BOE AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I në masën 65% dhe adresë Tirane Bulevardi Zogu i Pare, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë, dhe **DESARET COMPANY shpk me NIPT K01816001J në masën 35%** dhe adresë Tirane Njesia Bashkiake nr 11, Rruga " Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret",Pranë Kryqit të Kuq, Kati perdue, përfaqësuar nga **AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I** dhe adresë Tirane Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë dhe ofertuar në vlerën **353’613’604 (treqind e peëdhjetë e tremilion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa tvsh.**

e.1 Operatorët ekonomik deklarojnë se pajisjet me numër rendor 3, 7, 8, 9, 10, 11 do të furnizohen nga Klimateknika TB2 dhe ky i fundit është distributor i autorizuar i MIDEA, ALARKO/CARRIER.

Për këto prodhues nuk është paraqitur asnjë autorizim që të vërtëtohet lidhja prodhues distributor, kjo në kundërshtim me pikën **2.3.11.a** të DT:

2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.11, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim (i dedikuar për këtë procedurë prokurimi) nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. **Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.**

e.2 Për plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën **2.3.10** DT përsa i përket licensimit ISO, OE Aurora ka paraqitur dokumentin

2.5_ISO_9001-14001-45001__AURORA_KONSTRUKSION_2022.pdf

Nga shqyrtimi I dokumentacionit të dorëzuar rezulton se OE Aurora nuk ka paraqitur certifikatën **ISO 14001-2015**

Në DT përcaktohet shprehimisht:

2.3.10. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësisë si me poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën **ISO 45001:2018** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Në procesverbalin e hartuar nga njësia e prokurimit është argumentuar se:

“ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra

ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.”

Në bazë të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu, XI “Kushte të përgjithshme për zbatim”, Neni 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3:

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Sipas ndarjes së punimeve, operatori ekonomik **AURORA KONSTRUKSION shpk** ka marë përsipër realizimin e 65% të punimeve pra ka pjesën më të madhe në vlerë të realizimit.

OE Aurora Konstruksion shpk ka marë përsipër realizim punimesh (të ndara në % apo në total):

1. PUNIME ARKITEKTONIKE DHE NDERTIMI
2. PUNIME MEKANIKE
3. PAJISJE ARKITEKTONIKE DHE NDERTIMI
4. PAJISJE MEKANIKE

Për sa më lart, në zbatim të ligjit ky operator duhet të paraqiste certifikimin ISO 14001-2015 për Sistemin e menaxhimit të mjedisit.

e.3 Nga shqyrtimi i ofertës është konstatuar se në llogaritjen e vlerës së ofertës pa TVSH OE ka aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, vlerës totale (punime me tvsh + pajisje), pra (punime me tvsh+pajisje)/1.2

Në rastin konkret si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik shfaqen në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë *lex specialis*, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Referuar tabelës përmbledhëse të formularit të ofertës, konstatohet se punimet e kërkuara janë kategorizuar në:

- 1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**
- 2. PAJISJE**

Referuar udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, ndryshuar me udhëzimin Nr. 11, datë 13.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” Neni 20, “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, pargrafët 1,4 parashikohet:

TVSH-ja në ndërtim zbatohet:

1. Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.

4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:
 - a) Objekti që do të ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;
 - b) Objekti që do të ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSHsë të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbrësë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar ndërtimi i një objekti që do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma "a"

a), ku objekti që ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Në rastin konkret, në përlogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH.

Për sa kohë që paisjet e parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, në përlogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë **vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.**

Kryerja e veprimeve aritmetike, në mbledhjen e zërave të deklaruar, ka sjellë si rrjedhojë edhe vlerën totale ku përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndryshme nga vlera totale e preventivit, e cila, përbën një gabim në një vlerë më të madh se 2% duke cënuar procesin e prokurimit publik.

Oferta ekonomike dhe përlogaritja e zërave të deklaruar në preventivin e ofertës së kësaj procedure prokurimi, ka një llogaritje të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, vlera totale e preventivit pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, shërben si bazë për klasifikimin e ofertave, krahasimin e tyre, përlogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, si edhe mbi bazën e të cilës shqyrtohen dhe vlerësohet edhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart oferta e paraqitur me numra dhe me fjalë e operatorit ekonomik 353'613'604 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa tvsh dhe 424'336'325 (katërqind e njëzet e katërmilion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë me tvsh.

Pra operatori ekonomik i ka zbritur shumës totale, ku përfshihen edhe pajisjet, tvsh-në.

Vlera e preventivit të ofertuar (**1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**) është 285'260'354 lekë pa tvsh ose 342'312'425 ndërsa vlera e pajisjeve (**2. PAJISJE**) është 82'023'900 lekë.

Oferta e operatorit pa tvsh **DUHET** të ishte:

(Punime ndërtimi dhe instalime pa tvsh) 285'260'354+82'023'900 (pajisje)= 367,284,254 lekë pa tvsh

Vlera ekonomike pa tvsh është vlerë referuese për efekt krahasimi dhe vlerësimi të ofertave, vlera absolute e të gjitha korigjimeve, në këtë rast, është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave" Nr. 162/2020 "PËR PROKURIMIN PUBLIK", përcaktohet se:

"2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet."

Në Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, i ndryshuar parashikohet se:

3. *Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

- a) *Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- b) *Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- c) *Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.*
- d) *Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.*

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- **shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;**
- *shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.*

Kuadri ligjor në fuqi, *lex specialis* ka parashikuar rastet në të cilat, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton gabime aritmetike në hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. *Racio* e rregullimeve në rastet e gabimeve aritmetike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë, e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, Neni 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” i cili parashikon se:

1. *Pas afatit përfundimtar për hapjen e **ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës**, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*
2. *Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkojë që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.*
3. *Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.*

Gjithashtu, në interpretim sistematik dhe domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera të sistemit, konstatimi dhe mundësia e korrigjimit të gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike dhe rregullimet përkatëse, në thelb paraqiten si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ato të transparencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve

të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertuesin (**si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës**).

KVO këtë gjykim përvec zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, e mbështet edhe në vendimet e KLSH dhe të KPP.

KLSH për këtë rast shprehet:

..... AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlllogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. **Oferta ekonomike duhej të paraqitej si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit..... (Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyre me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie” Prill 2021)**

Si dhe vendimin e **K.P.P. 621/2019** ku citon:

Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen sëbashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e BOE AURORA KONSTRUKSION shpk dhe DESARET COMPANY shpk nuk kualifikohet



f. BOE BE - IS SH.P.K, shpk, me NIPT K71412003A në masën 30.06 % dhe adresë Kukes Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1 dhe 2 T shpk me NIPT K01731001M në masën 39.94% dhe adresë Tirane Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5 përfaqësuar nga BE - IS SH.P.K, shpk, me NIPT K71412003A dhe adresë Kukes Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1, dhe ofertuar në vlerën 355’307’385(treqind e pesëdhjetë e pesë milion e treqind shtatë mijë e treqind tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky BOE rezulton se:

f.1 Sigurimi i ofertës është me kohëzgjatje prej 150 ditësh në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DT

Në bazë të ligjit Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, Neni 83, Sigurimi i ofertës, pika 2 përcakton:

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në bazë të VKM, Neni 30, Sigurimi i ofertës, pika 3 përcakton:

*3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. **Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës.** Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.*

Në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” i ndryshuar, dhe ligjit për Prokurimin Publik, në dokumentat e tenderit pika 3.2 është përcaktuar:

a. Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 180 (njëqind e tetëdhjetë ditë)

f.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se operatorët pjesë e këtij bashkim operatorësh, janë mbështetur në kapacitete të tjera përkatësisht:

2T mbështetet në kapacitetet e OE UDHA shpk me NIPT K77524909Q dhe OE BE-IS shpk mbështetet në kapacitetet e OE AJSLI 2011 shpk me NIPT L13224001O.

Sipas DST pika 2.16 përcaktohet shprehimisht:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po



Jo

X

Operatori ekonomik nuk ka patur pretendime përsa i përket këtij kriteri, në fazën e pranimit të dokumentave. Për rrjedhojë cdo operator është i detyruar ti plotësojë të gjitha kriteret e përcaktuara në DT.

Sqarojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha **kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.**

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më lart mbështetja e OE në kapacitete të tjera është në kundërshtim më përcaktimet e AK në DT.

f.3 Nga shqyrtimi i preventivit i paraqitur nga ky BOE kontatohet se mungojnë disa zëra në preventivë. Zërat që mungojnë janë përkatësisht:

2. Punet Elektrike

2.3 Kanale metalike kabllorsh dhe tubat

2.3.1 - An

2.3.2 -An

2.3.3 -An

2.3.4 -An

Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, përcaktohet se:

“2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.”

Në Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, i ndryshuar, parashikohet se:

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.*

- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.
- d) Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

f.4 Nga shqyrtimi i ofertës është konstatuar se në llogaritjen e vlerës së ofertës pa tvsh OE ka aplikuar zbritjen e vlerës së TVSH-së, vlerës totale (punime me tvsh + pajisje), pra (punime me tvsh+pajisje)/1.2

Në rastin konkret si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik shfaqen në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë *lex specialis*, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Referuar dokumentaconit, punimet e kërkuara janë kategorizuar në:

1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME

2. PAJISJE

Sipas udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, ndryshuar me udhëzimin Nr. 11, datë 13.4.2023 “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Udhëzimin Nr. 6, Datë 30.1.2015 “Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar Në Republikën E Shqipërisë”, i ndryshuar” Neni 20, “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, pargrafët 1,4 parashikohet:

TVSH-ja në ndërtim zbatohet:

1. Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial. TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohët në librin e shitjeve dhe deklarohët në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket.

4. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata:
 - a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm;
 - b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm.

Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm.

Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përsa kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.

Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar ndërtimi i një objekti që do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma "a"

a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Në rastin konkret, në përlllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH.

Për sa kohë që paisjet e parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë **vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.**

Kryerja e veprimeve aritmetike, në mbledhjen e zërave të deklaruar, ka sjellë si rrjedhojë edhe vlerën totale ku përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar, të ndryshme nga vlera totale e preventivit, e cila, përbën një gabim në një vlerë më të madh se 2% duke cënuar procesin e prokurimit publik.

Oferta ekonomike dhe përlllogaritja e zërave të deklaruar në preventivin e ofertës së kësaj procedure prokurimi, ka një llogaritje të ndarë të secilit prej zërave të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, vlera totale e preventivit pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, shërben si bazë për klasifikimin e ofertave, krahasimin e tyre,

përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, si edhe mbi bazën e të cilës shqyrtohen dhe vlerësohet edhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart oferta e paraqitur me numra dhe me fjalë e operatorit ekonomik 355,307,385 (treqind e pesëdhjetë e pesë milion e treqind e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh dhe 426'368'862 (katërqind e njëzet e gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë me tvsh.

Pra operatori ekonomik i ka aplikuar heqjen e TVSH-së, shumës totale, ku përfshihen edhe pajisjet.

(KVO thekson se për këtë rast nuk mund të bëhet një krahasim i drejtë i ofertës së BOE BE-IS shpk dhe 2 T shpk me ofertuesit e tjerë për arsye të mos ofertimit të disa zërave në preventivë por do ta sjelli llogaritjen sipas vlerës së ofertuar ku në vlerën që do përmendet më poshtë do jetë vlera e deklaruar e BOE në të cilën nuk janë përfshirë cmimet e zerave që mungojnë)

Vlera e preventivit të ofertuar (**1. PUNIME NDERTIMI DHE INSTALIME**) është **273'628'815 lekë pa tvsh** ose 371,040,673.2 lekë me tvsh ndërsa vlera e pajisjeve (**2. PAJISJE**) është 55'328'189 lekë.

Oferta e operatorit pa tvsh **DUHET** të ishte:
273'628'815+55'328'189=328'957'004 leke pa tvsh

Vlera ekonomike pa tvsh është vlerë referuese për efekt krahasimi dhe vlerësimi të ofertave, vlera absolute e të gjitha korigjimeve, në këtë rast, është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se:
“2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.”

Në Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3 e Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.*
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.*
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.*

- d) Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi. [...]”.

Kuadri ligjor në fuqi, *lex specialis* ka parashikuar rastet në të cilat, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton gabime aritmetike në hartimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. *Racio* e rregullimeve në rastet e gabimeve aritmetike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë, e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, Neni 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave” i cili parashikon se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e **ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës**, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkojë që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

Gjithashtu, në interpretim sistematik dhe domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera të sistemit, konstatimi dhe mundësia e korrigjimit të gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike dhe rregullimet përkatëse, në thelb paraqiten si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ato të transparencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertuesin (**si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës**).

KVO këtë gjykim përveç zbatimit të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi, e mbështet edhe në vendimet e KLSH dhe të KPP.

KLSH për këtë rast shprehet:

..... AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlllogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. **Oferta ekonomike duhej të paraqitej si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit..... (Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie” Prill 2021)**

Si dhe vendimin e **K.P.P. 621/2019** ku citon:

Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e sipërcituar, ku krahas ndërtimit/rikonstruksionit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen sëbashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomik me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve.

KVO thekson se për këtë rast nuk mund të bëhet një krahasim i drejtë i ofertës së BOE BE-IS shpk dhe 2 T shpk me ofertuesit e tjerë për arsye të mos ofertimit të disa zërave në preventivë

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e BOE BE-IS shpk dhe 2 T shpk nuk kualifikohet



g. GENERAL TRADING sh.p.k, shpk me NIPT M21501011F dhe adresë Tirane Peze Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga Ben Mjalti, Njësia Administrative Pezë, pa ofertë ekonomike.

Për sa më lart KVO vendos me unanimitet se oferta e GENERAL TRADING sh.p.k, shpk nuk kualifikohet.



Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F në masën 89.95 %** dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3 dhe **K A C D E D J A shpk me NIPT K51712017A në masën 10.05%** dhe adresë Tirane Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dytë, përfaqësuar nga

AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT **K01725001F** dhe adresë Tirane DIBRES ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3 dhe ofertuar në vlerën **342'831'733.20 (treqind e dyzet e dy milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre.20) lekë pa tvsh** pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Institutit të Shëndetit Publik me adresë Rr. Aleksandër Moisiu, nr 80, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin për fundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
(I NGARKUAR NË DETYRË)**

MEJVIS KOLA